

VENDIM
Nr. 956, datë 7.12.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË DETAJEVE TË FORMULËS SË
UNIFIKUAR TË PIKËZIMIT PËR
PËRFITIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Formula e unifikuar e pikëzimit përfshin parametra të lidhur në mënyrë empirike me vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve, të tilla si: të ardhurat nga programi i mbrojtjes sociale, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia, blegtoaria, trashëgimia dhe dhuratat.
 2. Treguesit e vlerësimit, pjesë e formulës së unifikuar të pikëzimit, që ndihmojnë në përcaktimin e kriterëve të pranueshmërisë së familjeve për përfitimin e ndihmës ekonomike, përcaktohen sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
 3. Përditësimi i formulës së unifikuar të pikëzimit propozohet nga ministria përgjegjëse për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, në varësi të ndryshimeve të nivelit të varfërisë në vend, të publikuar nga INSTAT-i, dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
 4. Ngarkohet Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 dhjetor 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama